



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ARKIVI SHTETËROR I SISTEMIT GJYQËSOR

Nr. 369 Prot.

Tiranë, më 18/08/2023

URDHËR
Nr. 96 datë 18/08/2023
PËR

MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS

Në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 19, të ligjit nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 31.12.2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor” dhe Urdhrit nr. 4643/1, datë 31.01.2017, “Për miratimin e Rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Arkivit Shtetëror të Sistemit Gjyqësor”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur.
 2. Miratimin e standardit për formatin dhe përmbajtjen e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, sipas lidhjes nr. 2 bashkëlidhur.
 3. Miratimin e modelit të kërkesës dhe përgjigjes “Për dhënie të informacionit/ dokumentacionit” që do të përdoret nga ASHSGJ-ja, sipas lidhjes nr. 3 bashkëlidhur.
 4. Miratimin e akteve shkresore që do të përdoren nga ASHSGJ-ja, gjatë vendimmarrjes (neni 14/4, neni 15/3 dhe neni 17/5), sipas lidhjes nr. 4, bashkëlidhur:
 5. Përditësimin e programit të transparencës në përputhje me nenin 4 dhe pikën 2 të nenit 19 të LDI-së.
 6. Publikimin e Programit të Transparencës në faqen zyrtare të internetit të ASHSGJ-së: www.ASHSGJ.gov.al nën një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” dhe në mjediset e pritjes së publikut.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR

Dr. Alfred Çaušiu

